



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:302389

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500180

C.nr.224/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, në çështjen kontestimore të paditëses V.A.nga fshati G., Komuna e V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.S., avokat në F., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në bazë të licensimit, vlera e kontestit 1,374 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 25.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. MIRATOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.A.nga fshati G. Komuna e V., **detyrohet** e paditura Komuna e V. që paditëses, në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për licencim, për muajt Qershor – Dhjetor 2022 dhe për muajin Janar 2023, përkatësisht për 8 muaj, t’ia paguajë nga 113.67 €, në shumë të përgjithshme **909.36 €**, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë me datë 27.12.2023, deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses e kërkuar në emër të kompensimit të diferencës në pagë për shumën e përgjithshme prej 464.64 euro.

III. Detyrohet e paditura që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë 125 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën pasojën e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja V.A.nga G.i i Komuna së V., përmes të autorizuarit të saj av. R.S., me datë 27.12.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi në bazë të licensimit, duke kërkuar vlerën 1,374 euro.

Me padi, ka theksuar se ishte e punësuar si mësimdhënëse në SHFMU “S.R.” në fshatin Z., e cila ka punuar deri më datë 31.05.2023. Meqenëse paditësja është me diplomë fakulteti e nivelit Bachelor, për të cilën gjë i takon shtesa e të ardhurave personale apo 27 % e pagës bazë prej 421 € në muaj edhe atë, në përputhje me Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), ndërsa e paditura nuk e ka paguar, nga gjykata ka kërkuar që në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për licencim, për muajt Qershor deri në muajin Dhjetor të V.t 2022 dhe nga Janari 2023 deri më 31.05.2023, apo për 12 muaj t’ia paguajë nga 113.67 €. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, përkatësisht shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

Numri i lëndës: 2023:302389
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500180

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet e parapara nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministritë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Tutje ka theksuar se paditësja ka nënshkruar kontratën e punës sipas kualifikimit mësimdhënës, kriter ky për themelimin e marrëdhënies së punës në bazë të së cilës edhe realizon të ardhura sipas kësaj pozite. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë” dhe në rastin konkret, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar pasi që gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit, pasi themelësia e kërkesëpadisë është e bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, se paditësja është mësimdhënëse e kualifikuar me diplomë universitare 4 vjeçare, paga bazë e së cilës është 421 €, ndërsa nuk është kompensuar për licencim në shumën prej 113.67 € në muaj, fakte këto të mbështetura nga Vërtetimi numër 173/1, i datës 31.05.2023, Lista e pagave EM00163764, Diploma nr.511, e datës 04.08.2021, prova këto vendimtare për vendosje në këtë çështje kontestimore, pasi janë lëshuar nga organi kompetent, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës, duke provuar kështu saktësinë e thënieve në këto dokumente, ashtu siç është paraparë në nenin 329.1 të LPK-së.

Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadisë, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e mbështetur në dispozitat e nenit 55. 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: “I punësuar ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90. 5 i cili ka përcaktuar: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, lidhur me dispozitat e KKAK-së së datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, përkatësisht neni 3. 2 i cili ka përcaktuar se: “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratën Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”.

Në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008, në fuqi deri me datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike 19 %, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjeçar 27 % dhe me diplomë të 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35% të pagës bazë. Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Numri i lëndës: 2023:302389
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500180

Në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, duke i mbetur borxh nga 113.67 € për çdo muaj, pasi sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë është dashur të paguhet 27% të pagës bazë, e për këtë arsye e detyroi të paditurën si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pa bazuara këto pretendime, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditësit buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditësi është pranuar në punë sipas këtij kualifikimi dhe në kontratën e tij të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, për gjykatën ishte fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese pasi përqindjet sipas kritereve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kritereve.

Por, gjykata i ka refuzuar paditëses pjesën e kërkesës si në paragrafin II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për arsye se nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), një anshëm është tërhequr me datë 21.11.2022, ndërsa sipas Ligjit të Punës në fuqi me datë 06. Shkurt 2023, gjykata i ka llogaritur pagesën edhe për muajin Janar 2023, e jo edhe për muajt Shkurt deri në fund të muajit Maj 2023, siç ka kërkuar paditësja pasi që është e kualifikimit është rregulluar me Ligjin e Punës. Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyrua të paguajë shpenzimet e paditësit edhe atë, për taksën gjyqësore për padi shumë 21 € dhe për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, gjithsej 125 euro.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË V.
C.nr.224/2024, datë 25.03.2024

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.